



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2023  
Nr. Ref.:RK 2188/23

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI03/23

Parashtrues

Ali Zhushi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 138/2022 të 10 tetorit  
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka - Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Ali Zhushi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Nasuf Hasani, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Rev. nr. 138/2022] e 10 tetorit 2022 (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 nëntor 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 7 [Vlera], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 6 janar 2023, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 1 shkurt 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje të kërkesës së parashtruesit iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 18 janar 2023, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KIO3/23, caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KIO3/23, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 7 prill 2023, parashtruesi i kërkesës sipas kërkesës së Gjykatës, dorëzoi dokumente shtesë, gjegjësisht autorizim të vlefshëm.
10. Më 27 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri/me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 29 gusht 1983, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë pune me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK). Pas privatizimit të sektorit të shpërndarjes dhe të furnizimit të energjisë elektrike, parashtruesi i kërkesës vazhdoi kontratën e punës me kompaninë "KEDS" [në tekstin e mëtejme: punëdhënësi].
12. Më 1 nëntor 2015, u nënshkrua kontrata për autorizim, ndërmjet Federatës së Sindikatave të Pavarura "Elektro-Kosova" (në tekstin e mëtejme: Federata) dhe Nasuf Hasanit, avokatit të parashtruesit të kërkesës. Nëpërmjet autorizimit, palët u morën

vesh që, avokati në fjalë t'i përfaqësojë dhe t'i mbrojë interesat e të gjithë punëtorëve të federatës pranë kompanive KEDS dhe KESCO, dhe pranë gjykatave të rregullta.

13. Më 27 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës njoftohet nga punëdhënësi përkitazi me Vendimin [Nr. 376 ] për ndërprerjen e kontratës së punës.
14. Më 2 nëntor 2016, avokati i parashtruesit të kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), në emër të parashtruesit të kërkesës, për anulimin e Vendimit [Nr. 376] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
15. Më 6 tetor 2020, Gjykata Themelore ka mbajtur seancën e parë përgatitore. Në këtë seancë, ka marrë pjesë vetëm përfaqësuesi i punëdhënësit, ndërsa ka munguar avokati i parashtruesit të kërkesës, përkundër faktit që më 23 shtator 2020, ka pranuar ftesën për pjesëmarrje. Gjykata Themelore, ka vlerësuar që avokati nuk ka pasur autorizim personal nga parashtruesi i kërkesës, por vetëm nga federata. Prandaj, ka vendosur që seanca e radhës të mbahej më 2 nëntor 2020, dhe të ftohej personalisht parashtruesi i kërkesës.
16. Më 6 tetor 2020, Gjykata Themelore kërkoi nga Agjencia e Regjistrimit Civil që të siguronte adresën e parashtruesit të kërkesës, në mënyrë që t'i dërgonte ftesën për mbajtjen e seancës, më 2 nëntor 2020. Në adresën e siguruar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, Gjykata Themelore ka tentuar t'ia dërgojë ftesën, nëpërmjet dorëzuesve të vet, parashtruesit të kërkesës. Mirëpo, meqë adresa e parashtruesit të kërkesës nuk është gjendur, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [C. nr. 2650/16] të 19 tetorit 2020, vendosi që të gjitha komunikimet dhe dorëzimet ndaj parashtruesit të kërkesës, përfshirë ftesën për pjesëmarrjen në seancë, të bëheshin përmes afishimit në tabelën e shpalljeve.
17. Më 2 nëntor 2020, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore, në të cilën mori pjesë vetëm përfaqësuesi i punëdhënësit, ndërsa nuk është paraqitur parashtruesi i kërkesës dhe as avokati i tij. Në rrethanat e tilla, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [C. nr. 2650/16], me të cilin është konsideruar si e tërhequr padia. Të njëjtën, Gjykata Themelore e ka afishuar në tabelën e shpalljeve, dhe e ka konsideruar si dorëzim të rregullt ndaj palës në procedurë.
18. Më 2 nëntor 2020, avokati i parashtruesit të kërkesës ka dorëzuar parashtrësë në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës ka njoftuar se është i autorizuar i parashtruesit të kërkesës, autorizim të cilin e kishin lidhur më 12 tetor 2020.
19. Më 2 nëntor 2020, avokati i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi parashtrësën në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës e njoftoi gjyqtarin e rastit, për prezencën e tij në objektin e Gjykatës Themelore gjatë ditës së mbajtjes së seancës përgatitore. Në parashtrësë, avokati thekson që nuk ka pranuar ftesë për kohën e mbajtjes së kësaj seance.
20. Më 23 nëntor 2020, Gjykata Themelore lëshon njoftim për avokatin e parashtruesit të kërkesës, nëpërmjet së cilës e njofton për të gjithë rrjedhën e procedurës, përfshirë të gjitha veprimet procedurale që i kishte ndërmarrë Gjykata Themelore, përkitazi me njoftimin e parashtruesit të kërkesës për pjesëmarrjen në seancën e 2 nëntorit 2020, si dhe për Aktvendimin e 2 nëntorit 2020 për tërheqjen e padisë.

21. Më 30 dhjetor 2020, avokati i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi parashtruesën në shkrimoren e Gjykatës Themelore, nëpërmjet së cilës kërkon shkresat e lëndës. Të njëjtat, i pranoi më 13 prill 2021.
22. Më 19 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzon parashtruesë në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kërkon anulimin e Aktvendimit të 2 nëntorit 2020 për tërheqjen e padisë, dhe propozon kthimin në gjendjen e mëparshme.
23. Më 2 qershor 2021, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [C. nr. 2650/16], hodhi poshtë si të paafatshme propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme. Gjykata Themelore arsyetoi që, sipas Ligjit nr. 03/L006 për Procedurën Kontestimore, propozimi për kthimin e afatit për kryerjen e veprimit procedural, duhet të paraqitet brenda afatit 7 (shtatë) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin. Kurse, Ligji përcakton që pas kalimit të 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e mosveprimit, nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme. Gjykata Themelore vlerësoi që, nga 2 nëntori 2020, kur parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij kanë lëshuar veprimin procedural, deri më 19 prill 2021, kur avokati i parashtruesit të kërkesës ka dorëzuar propozimin për kthimin e gjendjes së mëparshme, kishin kaluar më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Rrjedhimisht, propozimi ishte paraqitur jashtë afatit.
24. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të 2 qershorit 2021 të Gjykatës Themelore për refuzimin e propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme.
25. Më 21 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [Ac. nr. 10028/21], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e 2 qershorit 2021 të Gjykatës Themelore.
26. Më 25 janar 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të 21 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
27. Më 10 tetor 2022, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktvendimit [Rev. nr. 138/2022], refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës, dhe la në fuqi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme i vlerësoi si të drejta dhe të ligjshme aktvendimet e gjykatave të rregullta, duke theksuar se vendimmarrja është në përputhje me dispozitat thelbësore të procedurës kontestimore. Gjykata Supreme konstatoi se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura me revizion, ishin të pabazuara.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon që akti i kontestuar, ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, dhe shkelje të Konventave dhe të instrumenteve të tjera ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Themelore ka shkelur të drejtat e lartcekura, për faktin që nuk e ka ftuar për pjesëmarrje në seancën përgatitore, sipas procedurave të parapara me Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, duke

shtuar se “Gjykata Themelore mua si përfaqësues i paditësit Ali Zhushi nuk më ka drejtuar ftesën për seancë, e duke qenë se Ali Zhushi jeton edhe sot e kësaj dite në adresën e njëjtë, siç edhe theksohet në padi, atëherë gjykata nuk ka vepruar sipas normativës së përkufizuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore”.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu që “në ditën e mbajtjes së seancës, përkatësisht me datën 02.11.2020, edhe pse isha informuar për mbajtjen e seancës, po këtë ditë i jam drejtuar me shkresë gjykatës që të më pajisë me të gjithë dokumentacionin përkatës që ishte vendosur në këtë seancë, e që, deri me datë 12 prill 2021, si rezultat i neglizhencës nga ana e gjykatës nuk kam arritur të posedoj aktvendimin me të cilin është konsideruar e tërhequr kërkesëpadia”.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon që, të gjitha këto veprime dhe mosveprime të Gjykatës Themelore, përbëjnë shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës, dhe në këtë mënyrë, iu mohua shqyrtimi gjyqësor i kontestit të punës.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 24**

##### **[Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

#### **Neni 31**

##### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
  3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
  4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
  5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

## Neni 6

### (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

## LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE Nr. 03/L-006

### KREU VIII

### DËRGIMI I SHKRESAVE

### Mënyra e dërgimit

#### Neni 114

Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

#### (Ndërrimi i adresës)

#### Neni 116

116.1 Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

116.2 Në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni paraqitet revizioni, afati i tillë zgjatet deri sa të kalojnë gjashtë muaj nga dorëzimi i vendimit i dhënë sipas revizionit, me të cilin revizioni hidhet poshtë, refuzohet apo vendimi i goditur me revizion ndryshohet.

116.3 Në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë para se të skadojë afati nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqitet propozimi për përsëritjen e procedurës, afati i tillë zgjatet deri sa të kalojë afati gjashtë muaj pas marrjes së formës së prerë të vendimit të dhënë në procedurën e përsëritur, kundër të cilit nuk është paraqitur ankesa, përkatësisht nga skadimi i afatit gjashtë muaj nga dita në të cilën palës i është dorëzuar vendimi i shkallës së dytë.

116.4 Po që se në procedurën sipas mjetit të goditjes së jashtëzakonshme prishet vendimi i formës së prerë dhe çështja kthehet në rigjykim, do të konsiderohet se afati nga paragrafi 1 i këtij neni as që ka filluar të ecë.

116.5 Në qoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e metutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj.

116.6 Komunikimi nga paragrafi 5 i këtij neni konsiderohet i kryer pas kalimit të shtatë ditëve nga dita e afishimit të shkresës në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

116.7 Në qoftë se përfaqësuesi për pranimin e shkresave e ndërron adresën deri në

skadimin e afateve nga paragrafët 1-3 të këtij neni, e për një gjë të tillë nuk e njofton gjykatën, atëherë gjykata, me shpenzimet e palës, ia cakton palës përfaqësuesin për pranimin e shkresave nëpërmjet të cilit do t'i dorëzohen shkresat, derisa mos të njoftohet nga pala se ka caktuar përfaqësues të ri me prokurë.

## **KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME**

### **Neni 129**

129.1 Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.

129.2 Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.

### **Neni 130**

130.1 Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.

130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

130.4 Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë.

### **Neni 131**

Nuk lejohet kthimi në gjendje të mëparshme nëse nuk është ruajtur afati për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme apo nëse pala nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

### **Neni 133**

133.1 Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit.

133.2 Lidhur me propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata cakton seancë vetëm kur një gjë të tillë e propozon pala shprehimisht. Po që se faktet në të cilat mbështetet propozimi janë të ditura botërisht (notore) gjykata nuk cakton seancë në asnjë rast. Po në këtë mënyrë gjykata vepron edhe kur faktet në të cilat mbështetet propozimi janë qartë të pajustificueshme, por edhe kur gjykata ka prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënien e vendimit sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

133.3 Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë.

133.4 Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë, përveç kur propozimi paraqitet nga shkaku i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*[...]*

34. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.*

35. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimi Rev. nr. 138/2022, të 10 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur,



në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashih neni 49 i Ligjit.

36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

[...]

(2) *“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

[...]

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).
38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që, akti i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, dhe shkelje të Konventave dhe të instrumenteve të tjera ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
39. Megjithatë, në thelb, Gjykata vëren se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë të drejtën për një gjykim të drejtë, respektivisht të drejtën për “qasje në drejtësi”. Në këtë kontekst, Gjykata do t’i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata



Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

**i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtës për “qasje në drejtësi”**

a) Parimet e përgjithshme

40. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6 të KEDNj-së është definuar në rastin [\*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar\*](#), nr. 4451/70, Aktgjykimi i 21 shkurtit 1975. Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GjEDNj-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në gjykatë” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së. Sipas GjEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile”, para një gjykate (shih, rastin e GjEDNj-së, [\*Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë\*](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84).
41. Gjykata në këtë kontekst thekson se e “drejta në gjykatë”, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih, rastet e GjEDNj-së, [\*Bëles dhe të tjerët kundër Republikës Çeke\*](#), nr. 47273/ 99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe [\*Nait-Liman kundër Zvicrës\*](#), 513557/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).
42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse, në një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë” përkatësisht “të drejtën e qasjes në gjykata”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së, [\*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar\*](#), cituar me lart, paragrafi 36).
43. Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti, duhet të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrjeje, që prekë vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definimi i këtyre dy koncepteve duhet të jetë përmbajtjesor dhe joformal (shih, në këtë aspekt, rastet e GjEDNj-së, [\*Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës\*](#), nr. 6878/75, 7238/75, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; [\*Moreira de Azevedo kundër Portugalisë\*](#), nr. 12686/03, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; [\*Boulois kundër Luksemburgut\*](#) nr. 37575/04, Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe [\*Boulois kundër Luksemburgut\*](#), nr. 37575/04, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih, rastet e GjEDNj-së, [\*Kutić kundër Kroacisë\*](#), nr. 48778/99, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; [\*Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë\*](#), cituar më lart, paragrafi 86 dhe referencat në të; [\*Acimović kundër Kroacisë\*](#), nr. 61237/00, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe [\*Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos\*](#), nr. 40786/98, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
44. Megjithatë, parimet e lartpërmendura nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së. Këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit, duke cenuar vetë



thelbin e të drejtës (shih, GjEDNj, [Baka kundër Hungarisë](#), nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 89). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi i tillë prekë thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim”, si dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 8225/78, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; [Nait-Liman kundër Zvicrës](#), cituar më lartë, paragrafi 65; dhe [Marković dhe të tjerët kundër Italisë](#), nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99). E drejta për qasje në gjykatë mund t’i nënshtrohet në rrethana të caktuara, disa kufizimeve legjitime, të tilla si afatet ligjore të parashkrimit, urdhrave që kërkojnë pagesën e një garancie, një kërkesë përfaqësimi (rastet e GjEDNj-së, [Stubblings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 22095/93, Aktgjykim i 22 tetorit 1996; [Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 18139/91, Aktgjykim i 13 korrikut 1995; [R.P. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 38245/08, Aktgjykim i 9 tetorit 2012).

45. Të gjitha këto parime të përcaktuara nga GjEDNj-ja, përkitazi me të drejtën për “qasje në drejtësi”, janë përdorur dhe etabluar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në zgjidhjen e rasteve konkrete kur palët kanë pretenduar mohimin e të drejtës për “qasje në drejtësi” (shih, rastet, në të cilat Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për qasje në drejtësi, [KI10/22](#), parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020; [KI143/21](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 25 nëntor 2021; [KI80/19](#), parashtrues *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2020; [KI214/21](#), parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, dhe rastet në të cilat nuk është konstatuar shkelje e së drejtës për “qasje në drejtësi”, [KI133/17](#), parashtrues *Ali Gashi*, Aktvendim i 29 korrikut 2019; [KI62/18](#), parashtrues *Nadlije Gojani*, Aktvendimi i 27 shtatorit 2018, [KI78/18](#) parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendimi i 27 shkurtit 2019, [KI92/21](#), parashtrues *Fadil Ponosheci*, Aktvendim i 21 tetorit 2021.

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Themelore kishte shkelur të drejtat kushtetuese të tij për faktin që kjo e fundit, sipas tij, nuk i kishte dorëzuar ftesën për pjesëmarrje në seancën përgatitore, sipas ligjit për procedurën kontestimore.
47. Gjykata bazuar në standardet dhe parimeve të lartpërmendura, përsërit se secili individ ka të drejtë që të paraqesë padi pranë një gjykate të themeluar me ligj, në lidhje me “të drejtat dhe detyrimet civile”, brenda një afati të arsyeshëm kohor. E drejta për “qasje në drejtësi”, paraqet një nga elementet kryesore të procesit të rregullt gjyqësor, si e drejtë e garantuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së. Kjo e drejtë përbën një nga atributet kryesore të një shoqërie demokratike, e cila bazohet në sundimin e ligjit.
48. E drejta për “qasje në drejtësi”, nënkupton faktin që individët kanë të drejtë për të përdorur mjete efektive juridike pranë gjykatave, në realizimin e të drejtave të tyre civile. Në lidhje me këtë, së pari duhet të ekzistojë një “kontest”, dhe së dyti, të ekzistojë një “e drejtë civile”.
49. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që, parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar dy kriteret e lartcekura në lidhje me të drejtën për “qasje në drejtësi” e para, të ketë një “kontest”, dhe e dyta, të ekzistojë një “e drejtë civile”. Në këtë rast, ka pasur një kontest mes parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit, përkitazi me ndërprerjen e

marrëdhënies së punës, dhe ekziston një e “drejtë civile”, për shkak të natyrës juridike të kontestit.

50. Megjithatë, Gjykata ka përsëritur po ashtu se e drejta për “qasje në drejtësi” nuk është absolute, sepse kjo e drejtë mund të kufizohet në raste të caktuara varësisht nga legjislacioni kombëtar. Mirëpo, kufizimi i kësaj të drejte nuk duhet të kufizojë individin për “qasje në drejtësi”, deri në masën sa cenohet thelbi i kësaj të drejte. Kur kjo e drejtë kufizohet nga ligji, Gjykata vlerëson nëse kufizimi i kësaj të drejte ka pasur një qëllim legjitim, dhe është proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet. Në kuadër të kufizimeve të kësaj të drejte, futen edhe kufizimet e natyrës procedurale, të tillat si afatet ligjore për parashtrimin e padisë, afatet për ushtrimin e ankesës në një gjykatë më të lartë dhe të tjera.
51. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për pjesëmarrje në seancë përgatitore, Gjykata i referohet Aktvendimit [C. nr. 2650/16] të 2 nëntorit 2020 të Gjykatës Themelore dhe vëren se kjo e fundit, kishte caktuar seancën e parë përgatitore më 6 tetor 2020, dhe e kishte ftuar avokatin e parashtruesit të kërkesës, megjithatë i njëjti kishte munguar në këtë seancë. Tutje, në aktvendimin e lartcekur vërehet se Gjykata Themelore më 2 nëntor 2020 caktoi seancën tjetër përgatitore, dhe vendosi që këtë radhë të ftojë personalisht parashtruesin e kërkesës. Megjithatë, sipas arsytimit të Gjykatës Themelore, adresa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte e shkruar me saktësi në padi, dhe si rrjedhojë korrierët e gjykatës nuk kishin arritur ta gjenin adresën e tij. Meqë ishte e pamundur të gjendej adresa e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore vendosi që njoftimin për mbajtjen e seancës, ta afishojë në tabelën e shpalljeve, nga 19 tetori 2020 deri më 2 nëntor 2020. Më 2 nëntor 2020, Gjykata Themelore mbajti seancën përgatitore, në të cilin nuk mori pjesë parashtruesi i kërkesës, dhe në këtë mënyrë, kjo e fundit nëpërmjet aktvendimit të lartcekur, e konsideroi të tërhequr kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
52. Gjykata, në vazhdim, i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit [Ac. nr. 10028/21] të 21 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, e cila refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se, konstatimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, dhe me shkelje të tjera, siç pretendon pala ankuuese. Për më tepër, Gjykata e Apelit, arsyetoi se propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme ishte parashtruar pas kalimit të afateve të parapara me nenin 130 të LPK-së, pasi nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se aktvendimi [C. nr. 2650/16] i 2 nëntorit 2020, me të cilin është konsideruar e tërhequr kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është publikuar në tabelën e shpalljeve, në të njëjtën datë dhe i autorizuar i parashtruesit të kërkesës, lidhur me këtë aktvendim është njoftuar më 23 nëntor 2020, ndërsa propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është paraqitur më 19 prill 2021, që nënkupton se parashtruesi i kërkesës ka humbur të gjitha afatet për kthim në gjendje të mëparshme.
53. Gjykata gjithashtu i referohet Aktvendimit [Rev. nr. 138/2022] të 10 tetorit 2022, të Gjykatës Supreme, e cila refuzoi si të pathemeltë, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme fillimisht adresoi pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me dorëzimin e autorizimit për përfaqësim, ku ishte pretenduar se autorizimi nga avokati ishte dorëzuar në Gjykatën Themelore para 2 nëntorit 2020. Përkitazi me këtë, Gjykata Supreme arsyetoi se një pretendim i tillë është i pabazuar, sepse nga shkresat e lëndës rezulton që avokati i parashtruesit të kërkesës nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore që e rregullojnë çështjen e përfaqësimit të palës në procedurë, sepse e kishte hartuar padinë në emër të parashtruesit të kërkesës dhe e kishte nënshkruar atë, mirëpo nuk kishte dorëzuar autorizim të vlefshëm për përfaqësim të palës. Gjykata Supreme, tutje arsyetoi se, në mungesë të adresës së parashtruesit të kërkesës, shkalla

e parë kishte tentuar që në rrugë të tjera të sigurojë adresën e parashtruesit të kërkesës, megjithatë në adresën e siguruar nga agjencia përkatëse e gjendjes civile, nuk ishte e mundur të komunikohet me parashtruesin e kërkesës, për rrjedhojë gjykata është detyruar që komunikimin ta bëjë nëpërmjet tabelës së shpalljeve.

54. Gjykata vëren që, Gjykata Themelore para se të merrte aktvendim për tërheqjen e kërkesëpadisë, kishte ndërmarrë disa veprime procedurale. Së pari, e kishte ftuar avokatin e parashtruesit të kërkesës në seancën e parë përgatitore. Së dyti, pasi avokati i parashtruesit të kërkesës nuk mori pjesë, dhe nuk e arsyetoi mungesën, Gjykata Themelore kishte caktuar një seancë të re përgatitore, duke ftuar këtë radhë personalisht parashtruesin e kërkesës. Së treti, nga pamundësia për të gjetur adresën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore më pas vendosi që ftesën për seancën e 2 nëntorit 2020, ta afishojë në tabelën e shpalljeve.
55. Siç është elaboruar edhe më sipër, përcaktimi i rregullave procedurale ka për qëllim sigurinë juridike, dhe administrimin sa më të mirë të drejtësisë. Në këtë kuptim, të gjithë aktorët e përfshirë në një proces gjyqësor duhet të tregohen të interesuar që t'i zbatojnë këto rregulla. Gjykata në rrethanat e këtilla konsideron se neglizhenca për tu interesuar për procedurën në dritën e rrethanave të këtij rasti nuk mund t'i atribuohet Gjykatës Themelore, pasi që kjo fundit ka bërë përpjekje të njëpasnjëshme për të vendosur komunikim të rregullt, me parashtruesin e kërkesës dhe me avokatin e tij.
56. Gjykata tutje vëren se parashtruesi i kërkesës, pasi ishte njoftuar më 25 nëntor 2020 për Aktvendimin [C. nr. 2650/2016] e 2 nëntorit 2020 të Gjykatës Themelore, më 19 prill 2021 pranë kësaj të fundit parashtrroi propozim për kthim në gjendjen e mëparshme, e cila me Aktvendimin [C. nr. 2650/16] e 2 qershorit 2021, e hodhi poshtë si të paafatshme një propozim të tillë, me arsyetimin se, *“sipas ligjit të procedurës kontestimore, kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme duhet të parashtrohet brenda 7 (shtatë) ditëve, nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin. Në çdo rast, sipas ligjit, pas kalimit të 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”*.
57. Gjykata vëren se përkitazi me pretendimin që ndërliqej me propozimin e parashtruesit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Supreme konfirmuan si të drejtë dhe të ligjshëm Aktvendimin [C. nr. 2650/16] e 2 qershorit 2021 të Gjykatës Themelore. Saktësisht në lidhje me këtë pretendim Gjykata Supreme arsyetoi se avokati i parashtruesit të kërkesës nuk kishte kryer obligimet e tij ligjore për përfaqësimin e klientit të tij. Si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme theksoi se gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë, me të drejtë kanë nxjerrë përfundimin se parashtruesi i kërkesës ka lëshuar të gjitha afatet ligjore për të kërkuar kthim në gjendje të mëparshme, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 130 të LPK-së.
58. Gjykata sa më lart vlerëson se arsyetimet e gjykatave të rregullta në lidhje me interpretimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore, ishin në një linjë me njëra-tjetrën. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk kishte kryer me kohë veprimet e lejuara procedurale, duke treguar neglizhencë në këtë proces. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, kjo neglizhencë nuk mund t'i atribuohet gjykatave të rregullta, si për sa i përket mosparaqitjes në seancat përgatitore, po ashtu edhe për sa i përket lëshimit të afateve ligjore për të kërkuar kthim në gjendje të mëparshme.
59. Për më tepër, Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj të lëshohet në mënyrën e interpretimit të ligjit, të bërë nga gjykatat e rregullta, për sa kohë vëren se interpretimi i të drejtës materiale dhe procedurale nuk ka qenë dukshëm arbitrar dhe qartazi i paarsyeshëm, sa të cenonte të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Thënë



këtë, Gjykata konsideron që gjykatat e rregullta nuk kanë interpretuar ligjin në mënyrë qartazi arbitrare, prandaj dhe nuk kanë cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

60. Andaj, sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me mohimin e “qasjes në drejtësi”, i përkasin kategorisë së dytë (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; andaj, si të tilla Gjykata i deklaroi qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.

## ii. Përkitazi me pretendimet e tjera

61. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, pretendon edhe shkelje të neneve 7, 21, 22, 24 të Kushtetutës. Megjithatë, nga elaborimi i pretendimeve të tij, vërehet që thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës është mohimi i “qasjes në drejtësi”. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata potencon që vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo akteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese. Kur pretendon për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, parashtruesi duhet të paraqesë dëshmi dhe argumente bindëse, për të dëshmuar shkeljet e supozuara (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
62. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## Përfundime

63. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: **(I)** pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj, përkitazi me mohimin e të drejtës për “qasje në drejtësi”, i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”, andaj si të tilla në baza kushtetuese, këto pretendime deklarohen qartazi të pabazuara; **(II)** pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 7, 21, 22, 24 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj të njëjtat, në baza kushtetuese deklarohen qartazi të pabazuara.
64. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 27 prill 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Grësa Caka-Nimani

